




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT			
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE			
ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-4764/15
Dep.		Br. Prot.	Prot No.
Nr. I faq.	02	Data	11.12.2015
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINË			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4186-15 për z.Bedri Bytyqi-Drejtori i Inspektionit në Komunën e Prizrenit, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-4186-15, për Zyrtarin e lartë, z.Bedri Bytyqi – Drejtor i Inspektionit në Komunën e Prizrenit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Bytyqi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Bytyqi është deklaruar se brenda afatit ligjor, do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-02-4731/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se biznesi individual "Internet C @ Fe Çlirimi&Vip.Net", tashmë është shuar në mënyrë vullnetare. Po ashtu z.Bytyqi ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit Anëtar Bordi i ndërmarrjes tjetër private "Ylli & Albani" Sh.p.k. (Dpk-dpki-03-02-4732/15). Me këto veprime z.Bytyqi ka shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

